



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Kulturës dhe Turizmit
Ministarstvo Kulture i Turizma
Ministry of Culture and Tourism

Deklarata e Performancës së ASHAK 2025

Data:	28.04.2026
AGJENCIA	Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës
MINISTRIA PËRGJEGJËSE	Ministria e Kulturës dhe Turizmit
Miratimi i Raportit të Performancës (Po/Jo)	Po
Vlerësimi përshkrues i performancës	
Vlerësimi përshkrues i performancës së Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës për vitin 2025 është bërë bazuar në dispozitat e Rregullores (QKR) nr. 12/2023 mbi Sistemin e Menaxhimit të Performancës për Agjencitë në kuadër të Administratës Shtetërore. Ekipi Punues për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësisë si Njësi Përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të hartimit të planeve të performancës dhe veprimtarisë për Agjencitë e MKRS (themeluar me Vendim me numër protokolli 5812/2025 të datës 06.11.2025), ka pranuar Draft Raportin e Performancës së Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës për vitin 2025 të përgatitur nga agjencia, me datë 27.03.2026. Ekipi punues për mbikëqyrjen e procesit të hartimit të planeve të performancës dhe veprimtarisë për agjencitë në pajtim me Rregulloren (QRK) nr. 12/2023 për Sistemin e Menaxhimit të Performancës për Agjencitë në kuadër të Administratës Shtetërore, përkatësisht nenin 9 të saj, ka mbajtur takim dhe ka shqyrtuar Draft Raportin e Performancës të Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, me ç ‘rast ka përgatitur komente dhe pyetje, të cilat i ka përcjellë tek agjencia përmes shkresës elektronike të datës 31.03.2026. Në vijimësi dhe në pajtim me dispozitat e Rregullores (QRK) nr. 12/2023, ekipi punues ka ftuar seancë të dialogut (siç parashihet edhe me nenin 9 të rregullores), për të diskutuar komentet dhe pyetjet e adresuara, rezultatet e arritura, si dhe zbatimin e objektivave të përcaktuara. Bazuar në analizën si dhe rezultatet e dialogut të performancës lidhur me Raportin e Performancës të ASHAK për vitin 2025, Ekipi Punues për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësisë si Njësi Përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të hartimit të planeve të performancës dhe veprimtarisë për Agjencitë ka hartuar vlerësimin përshkrues të performancës si në vijim:	

- Plani i Performancës së ASHAK për vitin 2025, i përgatitur sipas Shtojcës I të Rregullores (QKR) nr. 12/2023, ka pasur 4 objektiva kryesore të përcaktuara sipas kriterëve përkatëse.
- Secila nga objektivat ka pasur treguesit, vlerën bazë, vlerën e synuar, rezultatet, alokimin financiar dhe referencën në dokumente strategjike/politike.
- Raporti i Performancës së ASHAK për vitin 2025, i përgatitur sipas Shtojcës II të Rregullores (QKR) nr. 12/2023, ka ofruar informata lidhur me nivelin e zbatimit të objektivave, treguesit e arritshmërisë, vlerat e synuara, vlerat faktike, rezultatet e planifikuara, rezultatet e përfunduara dhe ato të papërfunduara si dhe shënimet shpjeguese.
- Nga raporti është konstatuar se objektivat e përcaktuara janë realizuar në masë të konsiderueshme.
- Bazuar në informatat e paraqitura, nuk ka opinion “të kundërt” ose “mohim opinionit” nga Raporti i fundit i Auditorit të Përgjithshëm për ASHAK.
- Bazuar në vlerësimin e rezultateve, ASHAK ka treguar performancë pozitive në të gjitha fushat e përgjegjësisë së saj të përcaktuara në objektivat përkatëse.
- Raporti ka ofruar dëshmi dhe të dhëna plotësuese për përmbushjen e objektivave si dhe burime konkrete për verifikimin e rezultateve të arritura.

Bazuar në të gjeturat e mësipërme, Ekipi Punues për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësisë si Njësi Përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të hartimit të planeve të performancës dhe veprimtarisë për Agjencitë, konstaton se Deklarata e Performancës për ASHAK për vitin 2025 është pozitive, pasi që është vërtetuar se Agjencia ka arritur objektivat e parapara me Planin e Performancës për vitin 2025.

Prioritetet e performancës

Në bazë të Rregullores (QKR) nr. 12/2023, kërkohet që të jepen edhe propozime për prioritetet e performancës për të ardhmen.

Lidhur me këtë, Ekipi Punues për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësisë si Njësi Përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të hartimit të planeve të performancës dhe veprimtarisë për Agjencitë, jep rekomandimet si në vijim:

- Në rastet ku objektivi nuk është arritur plotësisht, rekomandohet të kryhet analizë e detajuar e treguesve dhe vlerave të synuara, me qëllim identifikimin e shkaqeve dhe përcaktimin e masave për përmirësim në planifikimet e ardhshme.
- Mosrealizimi i plotë i objektivit “Përmirësimi i infrastrukturës fizike për institucionet e arkivave” është arsyetuar me faktin se parcela e ndarë nga Kuvendi Komunal për ANK–Mitrovicë nuk ka qenë në përputhje me kërkesat e projektit, për çka gjatë vitit janë zhvilluar takime zyrtare për sigurimin e një parcele adekuate. Megjithatë, rekomandohet intensifikim i koordinimit ndërinstitutional dhe ndërmarrja me kohë e veprimeve planifikuese, me qëllim të minimizimit të pengesave në realizimin e objektivave të ngjashme në të ardhmen.
- Rekomandohet gjithashtu dhe përfshirja e treguesve shtesë për të siguruar një qasje më të plotë të planit të performancës në të ardhmen.

Saranda Bogujevi, Ministre e Kulturës dhe Turizmit



nënshkrimi



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA/GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E KULTURËS DHE TURIZMIT
MINISTARSTVO KULTURE I TURIZMA
MINISTER OF CULTURE AND TOURISM
AGJENCIA SHETËTËRORE E ARKIVAVE TË KOSOVËS
DRŽAVNA AGENCIJA ARHIVA KOSOVA
THE STATE AGENCY OF KOSOVO ARCHIVES



**Raporti mbi zbatimin e Planit të Përfomancës së Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës,
për vitin 2025**

DATA	27.03.2026					
AGJENCIA	Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës					
MINISTRIA PËRGJEGJËSE	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit					
Misioni i Agjencisë	Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës është institucion i vetëm ekzekutiv i administratës shtetërore që organizon, drejton dhe kontrollon veprimtarinë arkivore në Republikën e Kosovës. Misioni i saj është evidentimi, pranimi, ruajtja, mbrojtja, rregullimi, përpunimi, konservimi, restaurimi, digjitalizimi, shfrytëzimi dhe publikimi i materialit arkivor.					
Objektivat	Treguesi(t)	Vlera e synuar	Vlera faktike	Rezultatet (Outputet) e planifikuara	Rezultatet (Outputet) e përfunduara (Po/Jo)	Shënim shpjegues
1. Avancimi i politikave zhvillimore në fushën e arkivave		Përfunduar	Përfunduar	Strategjia e arkivave shtetërore, miratuar	Jo	Strategjia Shtetërore për Arkiva ka kaluar të

	Politikat zhvillimore e avancuar					gjitha proceduar administrative ligjore, tani është në pritje të dërgimit për miratim nga MKRS në Qeveri.
		Përfunduar	Përfunduar	Rregullorja për trajnime profesionale, miratuar	Po	U miratua Rregullorja (QRK) nr. 02/2026 për programin, përmbajtjen, mënyrën dhe procedurat e organizimit të trajnimit profesional për zyrtarët arkivor
		Përfunduar	Përfunduar	Rregullorja për kushtet dhe kriteret e nxjerrjes së materialit arkivor jashtë Agjencisë, miratuar	Jo	Ka kaluar të gjitha procedurat, aktualisht është në pritje për miratim nga Ministri Draft-Rregullorja e MKRS-së nr. XX/2024, Për kushtet, kriteret dhe procedurat e nxjerrjes së materialit arkivor

						jashtë Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës.
		Përfunduar	Përfunduar	Rregullorja për dhënien e pëlqimit për themelimin e arkivave private, miratuar	Jo	Ka kaluar të gjitha procedurat, aktualisht është në pritje për miratim nga Ministri Draft-Rregullorja (MKRS) nr. XX/2024 “Për dhënien e pëlqimit për themelimin e arkivave private
		Përfunduar	Përfunduar	Miratimi i metodologjisë dhe udhëzuesve profesional për materialin arkivor.	Po	Janë miratua: -Udhëzuesi Metodik për Rregullimin e Materialit arkivor. - Udhëzuesi Metodik për Digjitalizimin e Materialit Arkivor. - Udhëzuesi Metodik për Konservimin dhe

						Restaurimin e materialit arkivor
<i>Digjitalizimi masiv i materialit arkivor dhe avancimi i shërbimeve arkivore për publikun</i>	Kapaciteti i ruajtjes së dokumentacionit në format digjital dhe të shtypur sipas standardeve ndërkombëtare i rritur	2 500 000 faqe	4 793 049 faqe	Dokumentet e digjitalizuara për shfrytëzim onsite dhe online	Po	Janë rregulluar dhe përgatitë për digjitalizim gjithsej 720 metra gjatësi lineare të materialit arkivor, që përfshin 5 544 kuti, respektivisht 4 162 711 faqe. Krahas kësaj, janë realizuar edhe punë konservimi dhe restaurimi për 1 201 faqe të formatit A3; janë digjitalizuar gjithsej 4 793 049 faqe të materialit arkivor. Nga kjo sasi, 4 370 418 faqe janë digjitalizuar nga Operatori Ekonomik, ndërsa 422 631 faqe janë digjitalizuar nga zyrtarët në Arkivat Ndërkomunale.

						Dokumentet e digjitalizuara janë në shfrytëzim onsite. Tejkalimi i sasisë së planifikuar ndërlidhet me përkrahjen financiare të MKRS, angazhimi i stafit me kohë të caktuar si dhe zhvillimi i praktikës së nxënësve të Shkollës “Hoxhë Kadri Prishtina” Fushë Kosovë, sipas Marrëveshjes së Bashkëpunimit.
	Menaxhimi dhe shfrytëzimi i materialeve arkivore në mënyre digjitale	Realizuar	Realizuar	Funksionalizimi dhe përdorimi i Sistemit Elektronik për Menaxhimin e Materialeve arkivore	Po	U funksionalizua Sistemi Elektronik për Menaxhimin e Materialeve Arkivore (SEMMA) dhe i njëjti ka filluar zbatimin në proceset operative të punës. Në

						vazhdimësi të këtij procesi, u realizua trajnimi i stafit për përdorimin e platformës SEMMA, me qëllim të sigurimit të një përdorimi efikas dhe të standardizuar gjatë punës së përditshme. Pas funksionalizimit të sistemit, në platformën SEMMA u integruan të dhënat bazë për 490 fonde dhe koleksione arkivore të Arkivit Qendror. Njëkohësisht, u funksionalizua edhe shërbimi për hulumtuesit, ku në platformën SEMMA janë regjistruar gjithsej 166 hulumtues, prej tyre 70 kanë
--	--	--	--	--	--	---

						parashtruar për hulumtim, ndërsa 38 kanë realizuar hulumtimin. Zbatimi i SEMMA-s ka ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e efikasitetit, transparencës dhe standardizimit të shërbimeve arkivore, duke forcuar njëkohësisht kapacitetet institucionale në drejtim të ruajtjes, administrimit dhe ofrimit të dokumentacionit arkivor në formë digjitale.
<i>Pranimi i materialit arkivor nga fondkrijuesit</i>	Pasurimi i fondeve arkivore	166 m.gj.	132 m.gj; 22 004 kuti arkivore; 69 libra; 204	Pranimi i 4176 metër gjatësi lineare (41760 kuti arkivore) të materialit arkivor nga	Po	U pranua materiali arkivor nga AKP, - regjioni i Pejës dhe Mitrovicës, në

			fashikuj, 5 regjistra dhe 3 libra të gjendjes civile (libra amë).	AKP në AShAK, realizuar. Pranimi rreth 180 metër gjatësi lineare (lëndë penale 25 m.gj. vitet 1996-1999; civile 155m.gj. vitet 1968-1999 – plotësim i fondit) të materialit arkivor nga Gjykata e Apelit në AShAK, realizuar.		sasi prej 15739 kuti arkivore. Po ashtu, si kërkesë urgjente u pranuan materiale arkivore nga komunat në veri të Kosovës, si rezultat i mbylljes së strukturave paralele dhe marrjes së fondit nga fondkrijuesit përkatës. Materiali arkivor i përfshin dokumentacion të krijuar nga ndërmarrjet shoqërore të rajonit të Mitrovicës Veriore, si dhe nga komunat Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan, me përmbajtje të gjerë administrative, urbanistike, kadastrale, civile
--	--	--	--	---	--	--

						dhe ekonomike. Totali i pranuar nga komunat veriore është 838 kuti arkivore; 69 Libra; 204 fashikuj dhe 3 m.gj. Gjithashtu është pranuar edhe material arkivor nga Banka Qendrore e Kosovës, që lidhet me veprimtarinë e Shërbimit të Kontabilitetit Shoqëror në sasi prej 49 m.gj. Materialet arkivore të Gjykatës së Apelit nuk janë pranuar për shkak të mungesës së hapësirës adekuate, pasi hapësirat e planifikuara janë shfrytëzuar për pranimin e materialeve
--	--	--	--	--	--	--

						arkivore urgjente dhe të paplanifikuara nga strukturat paralele të komunave veriore.
<i>Përmirësimi i infrastrukturës fizike për institucionet e arkivave</i>	Arkivi Qendror në Prishtinë i renovuar	Pjesërisht	Përfunduar	Zhvillimi i procedurave të tenderimit për renovim të AShAK dhe fillimi i renovimit të AShAK.	Po	Ka përfunduar renovimi i objektit të ASHAK-ut, i cili ka përfshirë ndërhyrje infrastrukturore në katin përdhese dhe në oborr. Po ashtu, ka përfunduar hartimi i projektit për renovimin e Depos Qendrore në Prishtinë, si dhe ka përfunduar procedurën e tenderimit për realizimin e punimeve të rinovimit. Në këtë fazë jemi të nënshkrimi i kontratës.

	Fillimi i punimeve për ndërtimin i ndërtesave në Arkivat Ndërkomunale Gjilan dhe Mitrovicë	0	Realizuar	Projekti i gatshëm për ekzekutim -Përfundimi i së paku fazës së parë të punimeve	Po	Është finalizuar projekti kryesor për ndërtimin e Objekteve të Arkivave Ndërkomunale në Gjilan dhe Mitrovicë. Për Objektin e ANK-Gjilan, kanë përfunduar të gjitha përgatitjet e dokumentacionit dhe është marr Leja e Ndërtimit. Ndërsa, në ANK – Mitrovicë, parcela e cila është ndarë nga Kuvendi Komunal, nuk i përgjigjet projektit. Gjatë vitit kanë vazhduar takimet zyrtare për sigurimin e një parcele adekuate. Në mbështetje të MKSR, për përmirësimin e infrastrukturës
--	--	---	-----------	---	----	--

						arkivore, kanë vazhduar punimet e restaurimit dhe adaptimit të objektit të vjetër të Kazermës për akomodimin e ANK – Prizren. Punimet po vazhdojnë sipas Planit dinamik të punës. Kanë përfunduar punimet e renovimit të depos së objektit ekzistues, duke përmirësuar ndjeshëm kushtet teknike dhe klimatike për ruajtjen e dokumentacionit arkivor në ANK – Pejë. Kanë përfunduar punimet e renovimit në objektin e siguruar për shfrytëzim
--	--	--	--	--	--	--

						afatgjatë nga Gjykata Themelore në Gjakovë, për ANK – Gjakovë. Tani pritet pranimi dhe montimi i rafteve metalike.
--	--	--	--	--	--	---